



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E SHTIMES
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Drejtoria për Arsim
Uprava za Obrazovanje/Department of Education

Data	27 dhjetor 2022
Nr	05/974
Për	z. Qemajl Aliu, kryetar i Komunës së Shtimes
Përmes	
Nga	Lulzim Sahiti, drejtor i Arsimit
Lënda	RAPORT VJETOR PËR PUNËN E DREJTORISË KOMUNALE TË ARSIMIT

GJASHTËMUJORI I PARË (I)

HYRJE

Drejtoria e Arsimit, përkundër sfidave të mëdha që ka pasur, në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësi të veta, gjatë gjashtëmuajorit të parë të këtij viti ka realizuar punë dhe detyra të shumta në funksion të ngritjes dhe përmirësimit të cilësisë në arsim dhe krijimit të kushteve më të mira në tri nivelet e arsimit parauniversitar të komunës së Shtimes.

Në funksion të zhvillimit, përmirësimit dhe ngritjes së cilësisë së arsimit në shkollat e komunës së Shtimes, Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA) ka realizuar në mënyrë sistematike vizita në institucionet edukativo-arsimore të nivelit të arsimit parauniversitar, të cilat kishin karakter mbështetës, monitorues dhe këshillues për drejtuesit e institucioneve dhe stafin mësimdhënës. Po ashtu, duke e ditur peshën dhe rëndësinë determinuese që kanë organet drejtuese dhe profesionale të shkollës në zhvillimin dhe përmirësimin e cilësisë në arsim, janë funksionalizuar dhe fuqizuar Këshillat Drejtues të Shkollave si dhe Aktivitetet Profesionale në mënyrë që ky mekanizëm determinues të ndikon drejtpërdrejt në ngritjen dhe përmirësimin e cilësisë në arsim për të realizuar punët dhe detyrat me përgjegjësi të lartë. Kështu që, Drejtoria e Arsimit ka zhvilluar takime të shpeshta me drejtorët e shkollave, pastaj me pedagogë dhe psikologë që veprojnë në kuadër të Shërbimit Pedagogjik - Psikologjik për t'i njoftuar për punët, detyrat, kompetencat dhe fuqinë që kanë në zhvillimin dhe përparimin e gjithëmbarshtëm të arsimit në komunën tonë.

Komuna e Shtimes për zhvillimin e gjithëmbarshtëm të arsimit ka ndërmarrë veprime konkrete në shumë dimensionet që garantojnë progres në ngritje të cilësisë, duke bashkëpunuar ngushtë edhe me organizata të ndryshme qeveritare dhe joqeveritare. Me këtë rast, vlenë të përmendet bashkëpunimi me GIZ-in gjerman, Kosova Population Foundation (KOPF), KFOR-in Turk, Organizatën Ndërkombëtare për Migrim (IOM), Balkan Sunflowers Kosova (BSFK), pastaj OJQ "Zëri i Romëve, Ashkalinjve dhe Egjiptianëve e të tjerë.

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR ARSIMIN NË SHTIME

Drejtoria e Arsimit e komunës së Shtimes menaxhon 10 institucione edukativo-arsimore dhe aftësuese (IEAA) me gjithsej 9 paralele të ndara, përmes të cilave ofron shërbime për 5239 nxënës, prej të cilëve 373 janë fëmijë parafillor dhe 129 fëmijë parashkollor. Bazuar në buxhetin e vitit 2022, nga totali i buxhetit të komunës së Shtimes për këtë vit që është **7.704.029 €**, gjë që **42.94%** e buxhetit vjetor komunal është i dedikuar për fushën e arsimit, përkatësisht **3,307,809.00 €**, që shfrytëzohet për paga dhe mëditje, mallëra dhe shërbime, shpenzime komunale, subvencione dhe transfera si dhe investime kapitale.

Në komunën e Shtimes arsimit parauniversitar është i organizuar sipas niveleve: Programi i arsimit parashkollor (0), fillor (1-5), i mesëm i ulët (6-9) dhe i mesëm i lartë (10-12). Të dhënat e hollësishme për këto nivele të arsimit parauniversitar janë të prezantuar në tabelën në vijim:

Nivelet e arsimit		Numri i paraleleve	Numri i fëmijëve/nxënësve		
			M	F	GJ
Niveli 0	Arsimi parashkollor (Çerdhe/kopsht)	7 grupmosha	46	65	129
	Arsimi parafillor (Klasa përgatitore)	22	188	185	373
Niveli 1	Arsimi fillor (1-5)	110	1080	972	2052
Niveli 2	Arsimi i mesëm i ulët (6-9)	81	820	737	1557
Niveli 3	Arsimi i mesëm i lartë (10-12)	55	570	558	1128
Gjithsej:		268	2704	2517	5239

Në kuadër të zyrës së Drejtorisë Komunale të Arsimit janë të punësuar katër veta, përfshirë edhe pozitën e drejtorit të DKA-së. Kurse, në kuadër të IEAA-të publike të të gjitha niveleve të arsimit parauniversitar të komunës së Shtimes, DKA ka të punësuar gjithsej 457 persona. Në këtë shumë të të punësuarve bëjnë pjesë mësimdhënës, edukatorë, asistentë për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta arsimore, personel administrativ (drejtorë, zëvendësdrejtorë dhe administratorë të shkollave), personel profesional (pedagogë, psikologë dhe bibliotekarë), personel ndihmës (fokistë, rojtarë, shtëpiak dhe pastrues). Të dhënat e të punësuarve sipas llojit, nivelit dhe gjinisë janë të prezantuar në tabelën në vijim:

Numri i personelit në institucionet edukativo-arsimore dhe aftësuese publike të nivelit të arsimit parauniversitar në komunën e Shtimes						
Niveli i institucionit	Gjinia	Lloji i personelit				Gjithsej personel
		Mësimdhënës	Personel administrativ	Personel profesional	Personel ndihmës	
Institucione parashkollore	M	0	0	0	1	1
	F	8	1	0	1	10
	GJ	8	1	0	2	11
Shkolla fillore dhe të mesme të ulëta	M	97	7	2	46	152
	F	186	2	2	4	194
	GJ	283	9	4	50	346
Shkolla të mesme të larta	M	46	0	0	9	55
	F	39	4	2	0	45
	GJ	85	4	2	9	100
Gjithsej personel	M	143	7	2	56	208
	F	233	7	4	5	249
	GJ	376	14	6	61	457

ORGANIZIMI I MËSIMIT JOFORMAL

Me qëllim që t'u ofrohet mësim (joformal) shtesë dhe aktivitete tjera edukative për të gjithë fëmijët që kanë nevojë, por në veçanti për fëmijët e komuniteteve: Ashkali dhe rom janë themeluar qendrat arsimore në Shtime, Gjurkoc dhe Vojnovc. Secila qendër ka koordinatorin e tyre, personel mësimdhënës (tutor) që ofron mbështetje mësimore, vullnetar që ndihmon zhvillimin e aktiviteteve të qendrës mësimore dhe mirëmbajtës që kujdest për mirëmbajtjen fizike të qendrës mësimore.

Themelimi i qendrave mësimore ka pasur për qëllim mbështetjen për zhvillim fizik, kognitiv, emocional dhe social të fëmijëve, rritjen e pjesëmarrjes së fëmijëve në arsimin parafillor, fillor dhe të mesëm të ulët, përmirësimin e vijueshmërisë në shkollë dhe rezultateve të të nxënësve, zvogëlimin apo eliminimin e braktisjes së shkollimit, përfshirjen e shtuar të fëmijëve në aktivitete jashtëmësimore, vetëdijësimin e komunitetit për rëndësinë e shkollimit të fëmijëve, përfshirjen aktive të prindërve në edukimin e fëmijëve dhe shtimin e mundësive për socializimin e tyre.

Numri i nxënësve në Qendrën Mësimore në Shtime

Nacionaliteti	Mashkuj	Femra	Gjithsej
Shqiptar	7	6	13
Ashkali	24	40	64
Rom	1	0	1
Gjithsej	32	46	78

Numri i nxënësve në Qendrën Mësimore në Gjurkoc

Nacionaliteti	Mashkuj	Femra	Gjithsej
Shqiptar	1	1	2
Ashkali	22	21	43
Gjithsej	23	22	45

Numri i nxënësve në Qendrën Mësimore në Vojnovc

Nacionaliteti	Mashkuj	Femra	Gjithsej
Shqiptar	11	6	17
Ashkali	8	8	16
Gjithsej	19	14	33

Për realizimin e punës së dy qendrave mësimore (Gjurkoc dhe Vojnovc) është nënshkruar një aneks-marrëveshje më 28. 12. 2021 për bashkëpunim ndërmjet Komunës së Shtimes dhe OJQ "Zëri i Romëve, Ashkalinjve dhe Egjiptianëve" përmes së cilës dy qendrat mësimore janë financuar në shumën prej 10,720.00 euro në buxhetin komunal të destinuar për pagat e personave (4 tutorëve) për 8 muaj të vitit 2022 që punojnë drejtpërdrejt në programin e qendrave mësimore në fjalë.

NUMRI I NXËNËSVE TË KOMUNITETIT ROM DHE ASHKALI GJATË VITIT SHKOLLOR 2021/2022

Arsimi parafillor (0)

KOMUNA	SHKOLLA	ROM		ASHKALI	
		M	F	M	F
Shtime	"Emin Duraku"-Shtime	0	0	4	7
	"Emin Duraku"-Davidovc	0	0	0	0
	"Lasgush Poradeci"-Gjurkovc	0	0	1	1
	"Lasgush Poradeci"-Vojnovc	0	0	2	2
Gjithsej sipas gjinisë:		0	0	6	8
Totali:		0		14	

Arsimi fillor dhe i mesëm i ulët (I-IX)

KOMUNA	SHKOLLA	ROM		ASHKALI	
		M	F	M	F
Shtime	"Emin Duraku"-Shtime	0	1	48	56
	"Emin Duraku"-Davidovc	0	0	0	0
	"Lasgush Poradeci"-Gjurkovc	0	0	18	20
	"Lasgush Poradeci"-Vojnovc	0	0	8	9
Gjithsej sipas gjinisë:		0	1	74	85
Totali:		1		159	

Arsimi i mesëm i lartë (X-XII)

KOMUNA	SHKOLLA	ROM		ASHKALI	
		M	F	M	F
Shtime	"Naim Frashëri"-Shtime	0	0	2	3
	Shkolla e Mesme Profesionale	0	0	9	10
Gjithsej sipas gjinisë:		0	0	11	13
Totali:		0		24	

EDUKIMI I FËMIJËVE NË MOSHË TË HERSHME DHE REGJISTRIMI NË ÇERDHE PUBLIKE

Krahas institucioneve tjera arsimore është duke punuar edhe Institucioni Parashkollor "Albiona Asllani" në Shtime. Ky objekt me standarde të larta dhe kushte moderne është në funksion të edukimit të fëmijëve në moshë të hershme. Prandaj, duke ditur rëndësinë e tyre, investimi në çerdhe publike për DKA-në do të jetë prioritet dhe shumë i rëndësishëm, sepse sa më të vegjël që regjistrohen fëmijët në institucione arsimore aq më shumë fëmijët përparojnë dhe përgatiten për rrugën e tyre drejt shkollimit. Për këtë do të angazhohemi në rihapjen e ish-çerdhes publike, e cila gjendet në Bashkësinë e Pestë të Shtimes, mandej adaptimin e ish-objektit të Zyrës së Vendit për çerdhe në Muzeqinë si dhe ndërtimin e institucioneve parashkollore në fshatin Godanc dhe Petrovë, gjë që ditë më parë në këtë Kuvend veçse janë ndarë lokacionet për ndërtimin e tyre. Interesimi për regjistrimin e fëmijëve në çerdhe është mjaft i madh ngase në raport me kërkesat rreth 60 fëmijë në këtë vit kanë qenë në listë të pritjes.

Në vitin shkollor 2021/2022 kemi pasur 7 grup-mosha të fëmijëve të regjistruar në IP "Albiona Asllani". Më poshtë mund të shihni tabelën:

Numri i fëmijëve në IP “Albiona Asllani” sipas grup-moshave në vitin shkollor 2021/2022

Nr. i grupeve	Grup-mosha	Meshkuj	Femra	Nr. i fëmijëve në grup
1	09 muaj-2 vjeç	3	10	13 fëmijë
2	2-3 vjeç	11	6	17 fëmijë
3	09-3 vjeç	7	8	15 fëmijë
4	3-4 vjeç	7	15	22 fëmijë
5	4-5 vjeç	16	8	24 fëmijë
6	3-5 vjeç	15	7	22 fëmijë
7	5-6 vjeç	5	11	16 fëmijë
Gjithsej:		64	65	129 fëmijë

Për zhvillimin e veprimtarisë së këtij institucioni publik janë të angazhuar gjithsej 25 punonjës, prej tyre 14 veta janë të angazhuar përmes Caritas Kosova.

Më 30 qershor 2022 kemi hapur konkursin publik për regjistrimin e 48 fëmijëve në IP “Albiona Asllani”.

Planifikimi për regjistrimin e nxënësve në klasën e parë (I) për vitin shkollor 2022/2023

Sipas Planit Dinamik të Punës, Drejtoria Komunale e Arsimit në Shtime, ka bërë përgatitjet me kohë për regjistrimin e nxënësve në klasën e parë të arsimit fillor për vitin shkollor 2022/2023. Me këtë rast, DKA në bashkëpunim me shkollat e komunës së Shtimes nga data 24 maj – 23 qershor 2022 ka bërë regjistrimin e nxënësve në klasën e parë dhe të fëmijëve në klasën përgatitore. Konform, Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr. 16-2004, në klasat e para të shkollave fillore të Komunës së Shtimes është bërë regjistrimi i fëmijëve, të cilët kanë mbushur moshën minimale 6-vjeçare.

1. Numri i paraleleve të planifikuar për regjistrim të nxënësve në klasën e parë të arsimit fillor për vitin shkollor 2022/2023 është 22 paralele,
2. Numri i nxënësve të planifikuar për regjistrim të nxënësve në klasën e parë të arsimit fillor për vitin shkollor 2022/2023 është 389 nxënës.

Numri i nxënësve të regjistruar në klasën e parë dhe përgatitore, në vitin shkollor 2022/2023

Shkolla	Vendi	Klasa e parë			Klasa përgatitore		
		M	F	Gj	M	F	Gj
“Abdullah Shabani”	Carralevë	11	6	17	3	9	12
	Zborc	6	6	12	6	7	13
“Bajram Curri”	Petrovë	27	27	54	21	13	34
	Mollopolc	4	6	10	5	5	10
“Emin Duraku”	Shtime	57	62	119	47	45	92
	Belinc	6	0	6	2	2	4
	Lagje	4	8	12	5	4	9
	Davidovc	5	8	13	6	4	10
“Hasan Prishtina”	Godanc	24	18	42	13	17	30
“Idriz Ajeti”	Pjetërshticë	7	10	17	9	10	19
“Lasgush Poradeci”	Muzeqinë	8	6	14	7	3	10
	Gjurkovc	6	6	12	0	2	2
	Vojnovc	7	6	13	4	1	5
	Rashincë	9	6	15	8	5	13
	Gllavicë	3	2	5	0	2	2
“Skënderbeu”	Reçak	14	10	24	11	10	21
Gjithsej:		198	187	385	147	139	286

Vërejtje: Numri i nxënësve/fëmijëve mund të rritet deri në shtator meqë në çdo vit të ri shkollor prindërit i sjellin fëmijët të regjistruhen edhe në fund të muajit gusht.

Planifikimi për regjistrimin e nxënësve në klasën e dhjetë (X) për vitin shkollor 2022/2023

Drejtoria Komunale e Arsimit në bashkëveprim me Departamentin e Arsimit dhe Aftësimin Profesional në Prishtinë dhe Shkollën e Mesme Profesionale në Shtime kanë ndërmarrë veprimet e nevojshme për identifikimin e drejtimeve/profileve, në të cilat do të regjistrohen nxënësit në vitin e ri shkollor 2022-2023. Sipas Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional, planifikimi i regjistrimit të nxënësve bazohet në hulumtimin për zhvillim ekonomik në rajon apo në komunën përkatëse. Andaj, në funksion të kësaj, për vitin shkollor 2022/2023 në Shkollën e Mesme Profesionale në Shtime është planifikuar të ketë pesë drejtime profesionale në shtatë profile.

Ndërkaq, në Gjimnazin “Naim Frashëri” në Shtime janë planifikuar për vitin shkollor 2022/2023 të regjistrohet gjithsej 175 nxënës.

Drejtoria e shkollave të mesme të larta të komunës sonë, me kohë kanë themeluar komisionet profesionale dhe përkatëse për regjistrimin dhe pranimin e nxënësve. Për kushtet dhe kriteret e regjistrimit të tyre, më 24 qershor 2022, DKA ka publikuar konkursin për regjistrimin e nxënësve në klasën e dhjetë (X) në arsimin e mesëm të lartë për vitin shkollor 2022/2023, në Gjimnazin “Naim Frashëri” dhe në Shkollën e Mesme Profesionale në Shtime për afatin e Qershorit. Afati i paraqitjes së dokumenteve për regjistrim ka qenë më 27, 28 dhe 29 qershor, ndërkaq rezultatet janë shpallur më 30 qershor 2022. Shih tabelën më poshtë me numrin e nxënësve të regjistruar në Shkollën e Mesme Profesionale:

Shkolla	Drejtimi	Profili	Paralele	Nx. të planifikuar për regjistrim	Nx. të regjistruar në afatin e qershorit
Shkolla e Mesme Profesionale-Shtime	Makineri	Instalues i ngrohjes dhe klimatizim	1	25	15
		Automekanik	1	25	8
	Elektroteknikë	Informatikë	1	25	16
	Bujqësi	Agrobiznes	1	25	12
	Ekonomi	Kontabilitet	1	25	12
		Banka dhe sigurime	1	25	14
	Hateleri	Asistent restoranti	1	25	11
Gjithsej:	6	7	7	175	88

Sqarim: Në drejtimin e shëndetësisë, përkatësisht në profilin: **Bashkëpunëtor profesional i infermerisë**, një paralele me nxënës të komunës sonë do të regjistrohen në Shkollën e Mesme të Mjekësisë “Elena Gjika” në Ferizaj dhe më pastaj për lehtësimin e kostos së shkollimit të tyre do të vazhdojnë mësimin si paralele e ndarë në Shkollën e Mesme Profesionale në Shtime. Për vazhdimin e punës së këtij profil arsimor, më 20. 6. 2022 kemi marrë konfirmimin edhe nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.

Kurse, në Gjimnazin “Naim Frashëri” në Shtime janë planifikuar për vitin shkollor 2022/2023 të regjistrohet gjithsej 175 nxënës. Shih tabelën më poshtë me numrin e nxënësve të regjistruar në Gjimnazin “Naim Frashëri”:

Shkolla	Drejtimi	Paralele	Nx. të planifikuar për regjistrim	Nx. të regjistruar në afatin e qershorit
Gjimnazi “N. Frashëri”	Gjimnazi i Shkencave Natyrore	3	75	75
	Gjimnazi i Shkencave Shoqërore-Gjuhësore	4	100	12
Gjithsej:		7	175	87

Në bazë të të dhënave nga Gjimnazi “Naim Frashëri” del se në Gjimnazin e Shkencave Natyrore kanë aplikuar gjithsej 110 nxënës prej të cilëve vetëm 23 nxënës nuk kanë arritur të plotësojnë kriteret e duhura për regjistrim, ndërkaq në Gjimnazin e Shkencave Shoqërore-Gjuhësore, kanë aplikuar gjithsej 104 nxënës prej të cilëve 92 nxënës nuk kanë arritur të regjistrohen. Për të gjithë nxënësit e paregjistruar në afatin e parë të Qershorit, do të kenë mundësinë të aplikojnë sërish për vendet e lira, në afatin e dytë të Gushtit, në konkursin plotësues nga data 22, 23 dhe 24 gusht 2022.

MASAT PARANDALUESE PËR BRAKTISJEN E SHKOLLIMIT

Përkundër lehtësirave që janë krijuar për shkollim, duke u shpërndarë nxënësve edhe libra falas nga MASHTI për arsimin e obliguar, braktisja e shkollës nga nxënësit mbetet ende evidente. Mirëpo, DKA së bashku me Këshillat Drejtues të Shkollave, për të parandaluar këtë dikuri ka themeluar në nivel shkolle dhe të komunës, Ekipet për Parandalim dhe Reagim kundër Braktisjes dhe Mosregjistrimit të nxënësve në arsimin parauniversitar (EPRBM). Të gjitha ekipet që veprojnë në kuadër të shkollave fillore dhe të mesme të ulëta (I – IX) kanë punuar maksimalisht për të parandaluar në kohë reale rastet e rrezikut të lartë të braktisjes dhe mosregjistrimit në institucionet e arsimit parauniversitar duke bashkëpunuar me institucionet përkatëse shtetërore, organizatat joqeveritare si dhe të gjitha grupet tjera të interesit.

Më **15 qershor 2022** është rithemeluar Ekipi Komunal për Parandalim edhe Reagim kundër Braktisjes dhe Mosregjistrimit në Arsimin e Obliguar, me këtë rast kemi evidentuar numrin e nxënësve braktisës, me të cilët janë duke punuar ekipet tona në terren për kthimin e tyre në procesin edukativo-arsimor.

Numri i nxënësve braktisës gjatë vitit shkollor 2021/2022

Shkolla	Vendi				
		M	F	Gj	Përqindaja
“Abdullah Shabani”	Carralevë	0	0	0	0.00 %
“Bajram Curri”	Petrovë	0	1	1	0.24 %
“Emin Duraku”	Shtime	11	2	13	0.84 %
“Hasan Prishtina”	Godanc	1	0	1	0.29 %
“Idriz Ajeti”	Pjetërshticë	0	0	0	0.00 %
“Lasgush Poradeci”	Muzeqinë	0	0	0	0.00 %
“Skënderbeu”	Reçak	0	0	0	0.00 %
Gjithsej:		12	3	15	0.41 %

VLERËSIMI I JASHTËM I NXËNËSVE

Divizioni për Standarde, Vlerësim dhe Monitorim që vepron në kuadër të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit në bashkëpunim me DKA-në bëjnë organizimin e përvitshëm të vlerësimit të jashtëm të nxënësve.

Një vlerësim i tillë që po bëhet për herë të tretë në vendin tonë është ai i Programit të OECD-së për Vlerësimin Ndërkombëtar të Nxënësve (PISA), ku më **17, 18 dhe 19 maj 2022** i janë nënshtruar 116 nxënës të komunës sonë. Me këtë rast, janë testuar për zbatimin praktik të njohurive në tri fusha kyçe që janë: Leximi, matematika dhe shkenca. Përndryshe, testi PISA është një hulumtim (vlerësim) ndërkombëtar në nivel botëror i cili realizohet nga Organizata për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ekonomik (OECD), në vendet anëtare dhe jo anëtare të kombeve për nxënësit 15 vjeçar, ku vlerësohet performanca e tyre në tri fusha të sipërpërmendura. Rezultatet do të publikohen në shtator të vitit 2023.

Më **22 maj 2022**, në Gjimnazin “Naim Frashëri” në Shtime për herë të dytë është bërë edhe pilotimi i një vlerësimi tjetër ndërkombëtar **TIMSS** (Studim Ndërkombëtar i Prirjeve në Matematikë dhe Shkencë), të cilit i janë nënshtruar 31 nxënës të klasave të katërta (IV) në matematikë dhe shkenca natyrore. Ky test ka besueshmëri të lartë dhe ka ndikim të rëndësishëm në zhvillimin e politikave

arsimore të vendeve që marrin pjesë. Testi TIMSS është studim që realizohet nën kujdesin e Bashkimit Evropian çdo pesë vjet dhe Kosova do t'i nënshtrohet vlerësimit final TIMSS në vitin 2023 ndërsa në vitin 2024, do të publikohen rezultatet. Vlerësimet e tilla përcaktojnë gjendjen e arsimit të një shteti.

Për nxënësit e klasave të nënta (IX) është organizuar **Testi i Arritshmërisë**, ku pjesa e parë e tij është mbajtur, më **4. 6. 2022** (e shtunë) në lëndët: Gjuhë amtare, gjuhë angleze, histori dhe gjeografi, ndërkaq më **14. 6. 2022** (e martë) është mbajtur pjesa e dytë, në lëndët: matematikë, informatikë, fizikë, kimi dhe biologji. Gjatë dy ditëve, nxënësit kanë pasur mundësinë të përgjigjen në 200 kërkesa (pyetje). Këtij testi i janë nënshtruar gjithsej 344 nxënës të klasave të nënta. U mbajt në dy qendra të testimit, gjegjësisht në Gjimnazin "Naim Frashëri" dhe në Shkollën e Mesme Profesionale në Shtime, ku të angazhuar për mbarëvajtjen e këtij procesi ishin të angazhuar 28 administrues (mësimdhënës) të këtyre dy institucioneve shkollore.

Përndryshe, ky test është i standardizuar, monitoruar dhe vlerësuar dhe ka për qëllim të masë nivelin e arritjeve gjatë katër viteve (VI-IX) të nxënësve me mbarimin e shkollës së mesme të ulët, pra mbarimin e klasës së nëntë. Gjithashtu, Testi i Arritshmërisë dëshmon shkallën e aftësisë të nxënësit për vazhdimin e shkollimit të mëtutjeshëm me orientim në bazë të rezultateve të arritura në testin e klasës së nëntë.

Më 22 qershor 2022, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit ka bërë publike rezultatet e Testit të Arritshmërisë për klasat e nënta, sipas të cilit arritshmëria në komunën e Shtimes është 41.02 për qind. Siç dihet, Testi i Arritshmërisë nuk ka karakter eliminues për nxënësit, por rangimi i tyre sipas rezultateve do t'u shërbejë si përparësi për regjistrimin e tyre në shkollimin e mesëm të lartë.

Rezultati i Testit të Arritshmërisë sipas shkollave – 2022

Nr.	Emri i shkollës	Pjesa	Nr. i nxënësve	Nr. i pikëve	Përqindja	Mesatarja
1	SHMU "Emin Duraku" – Shtime	I	152	7452	49.02 %	44.57 %
		II	151	6059	40.12 %	
2	SHFMU "Skënderbeu" – Reçak	I	21	1065	50.71 %	43.90 %
		II	20	742	37.10 %	
3	SHFMU "Abdullah Shabani" – Carralevë	I	33	1455	44.09 %	43.31 %
		II	32	1361	42.53 %	
4	SHFMU "Hasan Prishtina" – Godanc	I	30	1419	47.30 %	41.81 %
		II	30	1090	36.33 %	
5	SHFMU "Lasgush Poradeci" – Muzeqinë	I	44	1915	43.52 %	41.46 %
		II	44	1734	39.40 %	
6	SHFMU "Bajram Curri" – Petrovë	I	41	1756	42.82 %	37.45 %
		II	42	1348	32.09 %	
7	SHFMU "Idriz Ajeti" – Pjetërshticë	I	22	853	38.77 %	34.68 %
		II	22	673	30.59 %	
Arritshmëria mesatare:						41.02 %

Në pjesën e parë të testit, arritshmëria e shprehur në përqindje në lëndët: Gjuhë shqipe, gjuhë angleze, histori dhe gjeografi është 46.26 për qind, ndërsa në pjesën e dytë të testit, në lëndët mësimore: Matematikë, informatikë, fizikë, kimi dhe biologji, arritshmëria është 37.81 për qind.

Ndërkaq, **Testi i Maturës Shtetërore**, është mbajtur më **18 qershor 2022** (e shtunë), në tri Qendra të Testimit (Gjimnazi "Naim Frashëri", SHMU "Emin Duraku" dhe Shkolla e Mesme

Profesionale në Shtime). Ky provim, është organizuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) në bashkëpunim me Drejtorinë Komunale të Arsimit në Shtime. Provimi i matures ka filluar në ora 10:00, ndërsa ka përfunduar në ora 12:30. Për mbarëvajtjen e procesit, MASHTI ka angazhuar administrues (mësimdhënës) të shkollave të mesme të larta nga Ferizaj.

Këtij testi i janë nënshtruar gjithsej 348 maturantë (211 nxënës të Gjimnazit “N. Frashëri” dhe 137 nxënës të SHMP-së). Provimi i Maturës Shtetërore 2022, sivjet është mbajtur vetëm një ditë për të gjitha lëndët dhe për të gjithë nxënësit maturantë. Testi në fjalë, ka pasur gjithsej 100 kërkesa (pyetje, detyra), nga 25 kërkesa për secilën nga katër lëndët e përfshira dhe ka zgjatë 150 minuta. Në test kanë qenë të përfshirë tri lëndët obligative: Gjuhë amtare, gjuhë angleze, matematikë si dhe një lëndë zgjedhore që është përzgjedhur nga vet nxënësi nga mesi i lëndëve zgjedhore që ofrohen. Gjithashtu në këtë vit kemi pasur dy teste të ndryshme vetëm në lëndën e matematikës, njëri test ka qenë i njëjtë për gjimnazet e shkencave natyrore dhe gjimnazet matematikore, ndërsa testi tjetër për gjimnazin e shkencave shoqërore-gjuhësore dhe të shkollave profesionale. Për të kaluar me sukses Testin e Maturës nga 100 pyetje një nxënës duhet t’i ketë 40 për qind prej tyre të sakta.

Provimi i Maturës Shtetërore është një instrument matës, ku maturantët mund të tregojnë aftësitë dhe shkathtësitë e tyre, të cilat i kanë përvetësuar gjatë tri viteve të shkollimit të mesëm të lartë (X-XII). Divizioni për Standarde, Vlerësim dhe Monitorim, më 27 qershor 2022 ka bërë publike rezultatet. Shih më poshtë tabelën:

Rezultatet e Provimit të Maturës Shtetërore (afati i qershorit) në formë tabelare

Shkolla	Drejtimi	Nxënës që kanë hyrë në provim	Nxënës që kanë kaluar testin	Përqindja e kalueshmërisë	Përqindja e kalueshmërisë për shkollë
Gjimnazi “Naim Frashëri”	Gjimnazi Natyror	111	91	81.98 %	76.30 %
	Gjimnazi Shoqëror	100	70	70.00 %	
Shkolla e Mesme Profesionale	Ekonomi	26	5	19.23 %	37.22 %
	Makineri	17	5	29.41 %	
	Elektroteknikë	14	4	28.57 %	
	Bujqësi	19	5	26.31 %	
	Administratë	20	4	20.00 %	
	Hoteleri	12	1	8.33 %	
	Ndërtimtari	1	1	100.00 %	
	Shëndetësi	28	26	92.85 %	
Totali:		348	212	60.91 %	

Për të gjithë ata nxënës që nuk kanë arritur të kalojnë në afatin e parë Provimin e Maturës Shtetërore, më 27 gusht 2022, do të jetë afati i dytë, ku sërish mund t’i nënshtrohen Maturës Shtetërore.

PËRKRAHJA E NXËNËSVE TALENTË

DKA nëpërmjet drejtorëve të shkollave dhe Shërbimit Pedagogjik-Psikologjik ka bërë identifikimin dhe përkrahjen e nxënësve me inteligjencë dhe dhunti e talente të veçanta. Kjo kategori e nxënësve nga institucionet tona edukativo-arsimore kanë gëzuar vëmendje të posaçme dhe janë përzgjedhur për pjesëmarrje në gara komunale dhe republikane siç janë:

- Gara e XXII-të Republikane e “Fizikanëve të Rinj”, në Prishtinë;
- Olimpiada XIV-të Matematike e Kosovës (OMK 2022);
- Gara Komunale e Diturisë 2022;
- Gara e Diturisë “Mitrovica 2022”;
- Garat e Robotikës: Kosova Makers League Open 2021/22;

- Garat e Micro:Bit-it për klasat 1-5 nga British Council Kosovo,
- Kuizi i Diturisë "Big Bang" në RTV Dukagjini

Më **12 shkurt 2022**, në shkollën fillore "Emin Duraku" në Shtime është organizuar nga DKA, Gara Komunale e Fizikanëve të Rinj. Pjesëmarrës në këtë garë kanë qenë fituesit e garave shkollore të të gjitha shkollave të komunës sonë nga klasat 9, 10, 11 dhe 12. Nga kjo garë, komunën e Shtimes e kanë përfaqësuar në Garën Republikane, të mbajtur më **27 shkurt 2022**, në Departamentin e Fizikës në Prishtinë, këta nxënës:

1. Diona Sadriu (IX) – SHFMU "Abdullah Shabani"
2. Anesa Muharremi (X) – Gjimnazi "Naim Frashëri"
3. Kanita Shabani (XI) – Gjimnazi "Naim Frashëri" dhe
4. Kaltrina Rashiti (XII) – Gjimnazi "Naim Frashëri"

Në objektin e Shkollës Fillore "Emin Duraku" në Shtime, më **19 shkurt 2022**, Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA), ka organizuar mbajtjen e garës së matematikës në nivel komune me nxënësit e klasave të 9-ta, 10-ta, 11-ta, dhe të 12-ta. Persona përgjegjës për organizimin e Olimpiadës Matematike Komunale ishin mësimdhënësit e matematikës: Ardiana Sopaj dhe Isuf Rizani. Në garën e organizuar në bazë të kërkesës së Shoqatës së Matematikanëve të Kosovës, në Olimpiadën Matematike Komunale, morën pjesë gjithsej 17 nxënës nga 9 shkolla të komunës së Shtimes, ku nga ta janë përzgjedhur nxënësit më të suksesshëm në fushën e matematikës:

1. Eljesa Hajrizi (Klasa IX) – SHFMU "Skënderbeu"
2. Altuna Ahmeti (Klasa IX) – SHMU "Emin Duraku"
3. Sefedin Tahiri (Klasa X) – Shkolla e Mesme Profesionale
4. Aulona Aliu (Klasa X) – Gjimnazi "Naim Frashëri"
5. Jehona Behluli (Klasa XI) – Shkolla e Mesme Profesionale
6. Agon Selmani (Klasa XI) – Gjimnazi "Naim Frashëri"
7. Florend Ramusa (Klasa XII) – Gjimnazi "Naim Frashëri"
8. Fatlum Rushiti (Klasa XII) – Shkolla e Mesme Profesionale

Nxënësit e përzgjedhur nga kjo garë, më pas kanë marrë pjesë në Olimpiadën e XIV-të Matematike të Kosovës (OMK 2022) e cila është mbajtur më **5 mars 2022** në Gjimnazin e Specializuar Matematikor në Prishtinë.

Më **10 mars 2022**, SHFMU "Lasgush Poradeci" nga Muzeqina dhe paralelja e ndarë në Rashincë ishin pjesëmarrës në sfidën e dytë të garës me M-bota të organizuar nga Kosova Makers League Open 2021/22, përballë 113 shkollave të tjera në nivel të Kosovës. Ekipi i nxënësve "Fitimtarët" nga shkolla "Lasgush Poradeci" nga Muzeqina, me mentor Basri Fetahun përsëri arritën të renditen të parët, ndërsa ekipi i nxënësve "7200C" i shkollës "Lasgush Poradeci" nga Rashinca me mentor Adil Qorrollin për disa sekonda më pak është renditur në vendin e katërt.

Më 9 prill 2022, në hapësirën e BONEVET Prishtina është mbajtur punëtorja për ekipet fituese të raundit të dytë të Garës së Robotikës KML OPEN 2021-22. Pjesëmarrës në këtë punëtori ishin ekipet fituese të raundit të dytë: "Fitimtarët" nga SHFMU "Lasgush Poradeci" në Muzeqinë të ciklit "6-9" me mentor Basri Fetahun.

Më **3 qershor 2022** në sfidën e tretë të robotikës, ekipi "Fitimtarët" në përbërje të nxënësve: Buna Shahini, Leonis Kolgeci, Dhurata Biba dhe Ideal Kurtishi, me mentor Basri Fetahun arritën që të renditen në vendin e parë në nivel të Kosovës.

Më **30 mars 2022**, ekipi i shkollës fillore "Emin Duraku", përmes projektit "NOISE:BIT" ka arritur të rendit i pari në Kosovë, në **Garat e Micro:Bit-it për klasat 1-5**, të organizuar nga **British Council Kosovo**. Shkolla në fjalë është përfaqësuar në këto gara nga nxënësit: Shkurte Hasani dhe Dalmat Zeqa. Mentor i këtyre kampionëve ishte mësuesi Qëndrim Bajrami.

Me organizim të DKA-së dhe Shoqatës së Pedagogëve “Dituria”, më **6 maj 2022 (e premte)**, në SHMU “Emin Duraku” në Shtime është mbajtur Gara Komunale e Diturisë, ku dijen e tyre e kanë sfiduar gjithsej 243 nxënës të shtatë shkollave të mesme të ulëta të komunës sonë, prej të cilëve 110 nxënës janë fitues të vendeve të para, dyta dhe treta. Shikuar në bazë të gjinisë, prijnë femrat me 61 vende, kurse meshkujt kanë arritur të marrin vetëm 49 vende. Në Garën Komunale të Diturisë 2022 janë shënuar këto rezultate:

1. ShFMU “Emin Duraku” – Shtime, **vendi i parë**,
2. ShFMU “Lasgush Poradeci” – Muzeqinë, **vendi i dytë**,
3. ShFMU “Bajram Curri” – Petrovë, **vendi i tretë**.

Në formë tabelare vendet e fituara të shkollave pjesëmarrëse në Garën Komunale të Diturisë

Nr.	Shkolla	Vendi	Vendi (I)	Vendi (II)	Vendi (III)	Gjithsej
1	SHFMU “A. Shabani”	Carralevë	3	2	5	10
2	SHFMU “B. Curri”	Petrovë	4	9	4	17
3	SHFMU “E. Duraku”	Shtime	7	10	6	23
4	SHFMU “I. Ajeti”	Pjetërshticë	6	2	4	12
5	SHFMU “H. Prishtina”	Godanc	5	4	4	13
6	SHFMU “L. Poradeci”	Muzeqinë	6	8	7	21
7	SHFMU “Skënderbeu”	Reçak	5	2	7	14
Gjithsej:						110

Testit të diturisë i janë nënshtruar nxënësit e klasës së gjashtë, shtatë, tetë dhe nëntë, në nëntë lëndë mësimore: Gjuhë amtare, gjuhë angleze, gjeografi, histori, matematikë, biologji, fizikë, kimi dhe teknologji informative.

Për shkollat dhe nxënësit fitues, DKA me rastin e 12 Qershorit – Ditës së Çlirimit të Komunës së Shtimes, në Shtëpinë e Kulturës ka organizuar ceremoninë e ndarjes së mirënjohjeve të shoqëruar me një program të pasur kulturo-artistik. Ky organizim tashmë tradicional në komunën e Shtimes dita-ditës po masivizohet si për nga përmbajtja e një ashtu edhe për nga konkurrenca.

Më **10 maj 2022**, Shkolla e Mesme Profesionale në Shtime, ka marrë pjesë në Garat e Diturisë “Mitrovica 2022”, të organizuar nga Shkolla e Mesme Ekonomike “Hasan Prishtina” në Mitrovicë. Testimi i nxënësve pjesëmarrës është bërë në lëndën “Ekonomiksi i Mendimit Praktik”, ku nxënësit: Sylë Sadiku, Leonora Nuredini dhe Sefedin Tahiri arritën të zënë vendin e dytë. Me këtë rast, u shpërblyen me një lloptë, donacion nga GIZ-i gjerman dhe një mirënjohje.

Në Garën e Robotikës, të mbajtur më **28 shkurt 2022**, SHFMU “Hasan Prishtina” nga Godanci ka arritur sukses në sfidën e dytë të garës me M-bota të organizuar nga Kosova Makers League Open 2021/22 përballë 113 shkollave të tjera në nivel të Kosovës arritën të hyjnë në mesin e shkollave më të mira duke marrë 375 pikë nga 400 pikë maksimale. Ekipi “Fantastikët” nga shkolla e Godancit me këtë sukses ka kaluar në raundin e tretë të këtyre garave. Shkolla e Godancit në këto gara ka marrë pjesë me mësimdhënësin mentor, Kastriot Qarri dhe nxënësit: Sovran Halili, Shkurta Halili, Altion Ramadani dhe Rilind Ramadani.

Në ambientet e Klan Arena në Prishtinë, më **20 maj 2022**, SHF “Emin Duraku” është ftuar nga **British Council Kosovo** në ceremoninë përmbyllëse të programit “**Shkollat e Shekullit XXI**”, ku është shpërblyer me Vendin e Parë në Garat Kombëtare të Kodimit. Shkolla në fjalë ka fituar pako me pajisje të kodimit, siç janë: 28 pako me INVENTOR'S KIT, 40 pajisje MICRO:BIT Volume 1 dhe 280 pajisje MICRO:BIT Volume 2, të cilat do të përdoren nga nxënësit e kësaj shkolle. Po ashtu, British Council ka trajnuar stafin e shkollës në fushën: Mendimi kritik, zgjidhja e problemeve dhe sfida e kodimit.

SHFMU “Lasgush Poradeci” ka marrë pjesë në **Kuizin e Diturisë “Big Bang”** në RTV Dukagjini. Gara është organizuar në këto lëndë mësimore: Biologji, ekologji, gjeografi dhe edukatë qytetare. Shkolla në fjalë është përfaqësuar nga nxënësit:

1. Buna Haxhiu (klasa 6),
2. Dimal Haxhiu (klasa 7),
3. Dhurata Bibaj (klasa 8),
4. Leart Bajrami (klasa 9).

Drejtoria Komunale e Arsimit mbetet e përkushtuar të kontribuoj me të gjitha mundësitë që ka në dispozicion për t'i mbështetur të rinjtë e talentuar në lëndë të ndryshme mësimore.

AKTIVITETE SPORTIVE NË SHKOLLA

Në kuadër të aktiviteteve sportive, Shkolla e Mesme Profesionale në Shtime për nder të profesorit të ndjerë të edukatës fizike Xhafer Hysaj, nga **25 – 27 qershor 2022** ka organizuar turnirin tradicional në futboll, ku kanë marrë pjesë 12 ekipe.

Për nder të futbollistit Qerim Gashi, në SHFMU “Hasan Prishtina” në Godanc nga **24 – 26 maj 2022** është organizuar turniri në futboll, ku morën pjesë 8 ekipe nga kjo shkollë. Të gjitha ndeshjet ishin mjaftë interesante dhe prodhuan një rivalitet të theksuar sportiv. Gjithashtu nxënësit pjesëmarrës kanë treguar interesim dhe disiplinë të lartë gjatë zhvillimit të këtij turniri sportiv.

ORGANIZIME TJERA NË KUADËR TË INSTITUCIONEVE ARSIMORE

Me rastin e 14 vjetorit të Pavarësisë së Kosovës është shënuar **17 Shkurti** në të gjitha institucionet e arsimit me aktivitete të ndryshme.

Për nder të **7 Marsit – Ditës së Mësuesit** në të gjitha institucionet edukativo-arsimore të komunës së Shtimes është shënuar me aktivitete të ndryshme kjo ngjarje me rëndësi kulturore dhe historike. Gjatë kësaj dite, ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Arbërie Nagavci, në Bibliotekën Kombëtare në Prishtinë ka dhënë mirënjohje për mësimdhënësit e dalluar, në mesin e të cilëve nga komuna e Shtimes është shpërblyer Shefrije Nuha, profesoreshë në Gjimnazin “Naim Frashëri”.

Ndërkaq, në sallën e Asamblesë Komunale në Shtime, Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA) ka organizuar një ceremoni festive kushtuar 7 Marsit – Ditës së Mësuesit. Me këtë rast, DKA ka dhënë mirënjohje për mësimdhënësit e dalluar, mirënjohje post-morem për mësimdhënësit e ndjerë dhe mirënjohje për veteranët e arsimit.

Me rastin e **8 Marsit - Ditës Ndërkombëtare të Gruas**, Drejtoria Komunale e Arsimit për të gjitha punojnëset e institucioneve edukativo-arsimore të komunës së Shtimes ka dhuruar lule.

Më **21 mars 2022**, ka nisur punën kuzhina shkollë në ambientet e SHFMU “Lasgush Poradeci”, në Muzeqinë me një stafë prej katër anëtarëve. Në këtë kuzhinë me pajisje moderne, nxënësit kanë mundësinë të shërbehen me ushqime të freskëta, të gatuar pastër dhe të përgaditura mirë.

Më **30 mars 2022**, revista edukative-kulturore mujore e KFOR-it Magazine 4U - Magazina For You Shqip ka përzgjedhur shkollën fillore “Emin Duraku” si shkollë e muajit mars ku është shfaqur në ballinat e saja. Shkolla Fillore “Emin Duraku” është ndër shkollat e pakta në Kosovë që është e ndarë me objekt, dhe me drejtori sipas niveleve. Kjo do të thotë që shkolla fillore (klasat parashkollë ose niveli 0 dhe klasat 1-5 ose niveli i parë) e ka objektin e saj, dhe shkolla e mesme e ulët (klasat 6-9 ose niveli i dytë) i vijon mësimet në një objekt tjetër të ndërtuar më vonë.

Në shenjë të ruajtjes së ambientit që na rrethon gjegjësisht **22 Prillit – Ditës së Tokës** nxënësit e shkollave bashkë me mësimdhënësit e tyre kanë organizuar aktivitete të ndryshme duke mbjellur lule e drunjt dekorativ nëpër oborre të shkollave.

Më **17 maj 2022** për të gjithë nxënësit e klasave të para të komunës së Shtimes është organizuar shënimi i Festës së Abetares, me një program të pasur kulturo-artistik të gërshetuar me

këngë, valle e recitime. Në shënimin e Festës së Abetares morën pjesë mësues, prindër, nxënës e të tjerë.

Më **26 maj 2022**, në Shkollën e Mesme të Ulët “Emin Duraku” të Shtimes nga Klubi i Gjelbër i kësaj shkolle është organizuar aktiviteti tashmë tradicional **“Sofra Shkollore, 2022”**. Tryeza shkollore ishte mbushur përplot me ushqime të llojllojshme, të përgatitur nga nxënësit e kësaj shkolle dhe prindërit e tyre. Ky aktivitet shkollor që organizohet për nëntë vite me radhë ka për qëllim sigurimin e një fondi për zhvillimin e aktiviteteve shkollore. Gjatë këtij aktiviteti, nxënësit e shkollës kanë shfaqur një program të pasur kulturo-artistik të gërshëtuar me këngë, valle e recitime.

Për nder të **1 Qershorit – Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve** në institucionet tona arsimore janë organizuar aktivitete të ndryshme për fëmijë. Me këtë rast, për 129 fëmijët e Institucionit Parashkollor “Albiona Asllani” në Shtime janë dhuruar lodra nga Komuna. Gjithashtu shfaqje për fëmijë ka pasur në Shtëpinë e Kulturës, pastaj defilim deri te Stadiumi i Qytetit, ku atje fëmijët kanë zhvilluar aktivitete sportive, muzikë, ngjyrosje, lojëra edukative e të tjerë. Ky organizim është bërë në bashkëpunim me Komunën e Shtimes, SHF “Emin Duraku” dhe organizatat: “Balkan Sunflowers Kosova”, “Art Stars Union” dhe “Akademia-Edukim, Inovacion, Zhvillim Profesional”.

Me rastin e 23 vjetorit të çlirimit të komunës së Shtimes, të gjitha institucionet arsimore kanë organizuar një varg aktivitete në kujtim të ditës historike të **12 Qershorit**.

Në Shtëpinë e Kulturës në Shtime, me rastin e përfundimit të tri viteve të shkollimit të maturantëve, Gjumnazi “Naim Frashëri” në Shtime, më **16 qershor 2022** ka organizuar Ceremoninë e Diplomimit “Matura 2022”. Në këtë ceremoni, 194 nxënësit u ftuan për të marrë diplomat bashkë me mësuesin e tyre, ku në fund u bë edhe hedhja e përbashkët ceremoniale e kapelave. Ky organizim, gjithashtu është shoqëruar edhe me këngë e valle të përgaditura nga nxënësit e gjumnazit.

Në kuadër të bashkëpunimit me Policinë e Kosovës kemi mundësuar zyrtarëve policorë angazhimin dhe qasjen aktive në ofrimin e sigurisë në shkolla, përmes implementimit të Planit të Veprimit **“Siguria në Shkollë”**. Me këtë rast, Njësia e Trafikut Rajonal gjatë muajit prill ka mbajtur ligjëratat me nxënës të shkollave tona me temën: **“Njohuri elementare për sigurinë në trafikun rrugor”**. Ligjëratat janë mbajtur me nxënës të klasave të pesta, të cilat kanë pasur synim të plotësojnë nxënësit me njohuri shtesë dhe të domosdoshme në fushën e rregullave primare të sigurisë në trafik.

Në vazhden e bashkëpunimit me zyrtarët policorë të Shtimes, në shkollat tona janë zhvilluar gjithashtu ligjëratat me temën **“Substancat narkotike dhe pasojat e tyre”**, ku interesimi ka qenë mjaft i madh duke pasur në bashkëbisedim policinë, nxënësit dhe mësuesin se si duhet mbrojtur veten, parandaluar dhe raportuar këtë dukuri të dëmshme shoqërore.

Për vetëdijësimin e nxënësve kundër dukurive negative, në shkollat tona, Policia e Kosovës ka mbajtur ligjëratat me nxënësit e klasëve 8 dhe 9 me temën: **“Dhuna në Familje”**.

GJITHËPËRFSHIRJA E FËMIJËVE/NXËNËSVE ME NEVOJA TË VEÇANTA ARSIMORE

DKA së bashku me institucionet edukativo-arsimore është duke u kujdesur vazhdimisht për gjithëpërfshirjen e fëmijëve/nxënësve në arsim, pavarësisht kushteve të tyre fizike, intelektuale, sociale, emocionale, gjuhësore ose kushte të tjera. Aktualisht, kemi të punësuar dy asistentë për fëmijë/nxënës me nevoja të veçantë arsimore, të cilët janë të angazhuar drejtpërdrejt në procesin edukativo-arsimor.

Më **2 qershor 2022** është themeluar edhe Ekipi Vlerësues Pedagogjik për Fëmijë/Nxënës me Nevoja të Veçanta Arsimore, me këtë rast kemi evidentuar gjithsej 28 nxënës me nevoja të veçanta arsimore, për të cilët në vitin e ri shkollor 2022/2023 do të ketë vlerësim pedagogjik për t’ju mundësuar arsimim të përshtatshëm bazuar në nevojat individuale të tyre.

Numri i nxënësve të evidentuar nëpër shkolla me nevoja të veçanta arsimore

Nr.	Shkolla	Femra	Meshkuj	Gjithsej
1	SHF "Emin Duraku" - Shtime	2	8	10
2	SHMU "Emin Duraku" - Shtime	0	0	0
3	SHFMU "Abdullah Shabani" - Carralevë	1	2	3
4	SHFMU "Hasan Prishtina" - Godanc	0	2	2
5	SHFMU "Idriz Ajeti" - Pjetërshticë	0	0	0
6	SHFMU "Bajram Curri" - Petrovë	1	0	1
7	SHFMU "Lasgush Poradeci" - Muzeqinë	3	4	7
8	SHFMU "Skenderbeu" - Reçak	4	1	5
Gjithsej		11	17	28

BURSA PËR STUDENTË

Më **14 qershor 2022**, Drejtoria Komunale e Arsimit ka shpallur Konkurs për Ndarjen e Bursave për studentë të Komunës së Shtimes për vitin akademik 2021/2022. Në vitin paraprak janë ndarë 24 bursa për student, ndërsa sivjet është bërë dyfishimi i tyre dhe do të ndahen 50 bursa për studentë. E gjithë kjo ka ndodhur falë mjeteve të bartura, që janë aprovuar më 31 maj 2022, në seancën e Kuvendit Komunës së Shtimes, përmes së cilës janë rritur subvencionet 50 për qind në sektorin e arsimit. Shtimi i numrit të studentëve që do të marrin bursë, do të jetë një mbështetje e fuqishme dhe motiv shtesë, për studentët e dalluar që ta shtojnë përkushtimin e tyre në drejtimet e studimeve që ndjekin. Bursat do të ndahen për 10 (dhjetë) muaj dhe shuma mujore e tyre është 50 euro për student, gjegjësisht 500 euro për një vit. Deri në mbyllje të konkursit kanë aplikuar gjithsej 82 studentë.

EKSKURSIONI ME NXËNËS MATURANTË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ për Aktivitete Jashtëshkollore, nr. 02/2016 të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë prej datës **16 – 19. 5. 2022** është organizuar ekskursioni për nxënësit maturantë të Shkollës së Mesme Profesionale në Shtime:

- 16. 5. 2022 – Vizitë në qytetin e Lezhës (te varri i Skënderbeut), vizitë në qytetin e Shkodrës dhe më pastaj në mbrëmje nxënësit janë vendosur në hotel "Lumi" në Durrës,
- 17. 5. 2022 – Vizitë në qytetin e Krujës, përkatësisht në Muzeun Kombëtar "Gjergj Kastrioti-Skënderbeu";
- 18. 5. 2022 – Vizitë në qytetin e Vlorës, gjegjësisht në Shtëpinë e Pavarësisë;
- 19. 5. 2022 – Vizitë në qytetin e vjetër të Durrësit, vizitë te Muzeu Arkeologjik, pastaj te Amfiteatri antik i Durrësit dhe vizitë në kryeqytetin e Shqipërisë-Tiranë.

Në këtë ekskursion kanë marrë pjesë 113 nxënës. Shkuarja dhe ardhja e tyre është bërë nga Agjencia Turistike "Cufa Reisen". Mbulimi i shpenzimeve është bërë nga vet nxënësit dhe kostoja financiare për kokë nxënësi ishte 90 euro.

Ndërkaq, për nxënësit maturantë të Gjimnazit "Naim Frashëri" nga **19 – 20. 5. 2022** është organizuar ekskursioni në Republikën e Shqipërisë:

- 18. 5. 2022 – Fillimisht kanë vizituar qytetin e Lezhës (te varri i Skënderbeut), qytetin e Shkodrës dhe kryeqytetin e Shqipërisë - Tiranën. Më pastaj, nxënësit janë vendosur në hotel "Kolaveri" në Durrës,
- 19. 5. 2022 – Vizitë në qytetin e vjetër të Durrësit dhe në amfiteatrin antik, pastaj kanë vizituar qytetin e Krujës, përkatësisht Muzeun Kombëtar "Gjergj Kastrioti-Skënderbeu".

Në këtë ekskursion kanë marrë pjesë gjithsej 170 nxënës. Bartja e tyre është bërë nga Agjencia Turistike “Arditi Tours”. Mbulimi i shpenzimeve është bërë nga vet nxënësit dhe kostoja financiare për kokë nxënësi ishte 51 euro.

Ekskursionet shkollore janë formë jashtëmësimore që kanë për qëllim njohjen e një vendi me të gjitha vlerat e tij kulturore, historike, gjeografike, etnografike. Të gjitha shtetet u ofrojnë nxënësve të tilla organizime dhe ekskursione me karakter mësimor.

MBRËMJA E MATURËS

Më **21 maj 2022** (e shtunë) është organizuar Mbrëmja e Maturës për 321 nxënës të Gjimnazit “Naim Frashëri” (194) dhe të Shkollës së Mesme Profesionale të Shtimes (127), e cila është mbajtur në restorantin “BA - Place” në Davidovc. Këtë aktivitet e kanë organizuar drejtoritë e dy shkollave të lartshënuara. Për mbarëvajtjen dhe sigurinë u përkujdes gjatë gjithë kohës, Policia e Kosovës, me një organizim të shkëlqyeshëm. Nxënësit kanë kaluar këtë natë të hareshme me një atmosferë të mrekullueshme dhe pa asnjë ekces. Mbulimi i shpenzimeve është bërë nga vet nxënësit dhe kostoja financiare për kokë nxënësi ishte 24 euro.

SHËTITJET NJËDITORE NGA NXËNËSIT E KLASAVE TË NËNTA

Në fund të muajit maj dhe në fillim të muajit qershor 2022, për nxënësit e shtatë shkollave të mesme të ulëta, respektivisht për nxënësit e klasave të nënta është organizuar shëtitje njëditore nëpër Kosovë. Zakonisht gjatë këtyre shëtitjeve, vizitohet qyteti i Prizrenit, gjegjësisht ndërtesa e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, Kalaja e Prizrenit etj, mandej vizitohet vendburimi i lumit Drin i Bardhë që ka rrjedhën rrëzë malit të Rusolisë nga gurra e shpellës së Radavcit (Pejë), në 586 metra lartësi mbidetare, i cili përndryshe njihet si lumi më i madh i gjeografisë shqiptare. Vizitohet Prekazi legjendar prej ku ka nisur liria e Kosovës, Shpella e Mermertë e Gadimes, një nga vlerat më të bukura dhe më të rralla speleologjike në Evropë, vizitohen shpatijet e Sharrit siç është Prevala dhe Brezovica piktoreske, mandej Ujëvara e Mirushës në fshatin Llapçevë (Malishevë), Burimi i Istogut me rrjedhje prej 2,500 litra ujë në sekondë, i cili buron në lartësi mbidetare 480 metra si dhe vendbanime tjera turistike.

ORGANIZIMI I PIKNIKUT PËR NXËNËS FILLORISTË (I-V)

Për nxënësit e shkollave fillore (I – V), realizohet pikniku dy herë në vit, në fillim të vitit shkollor dhe në përfundim të vitit shkollor. Dita e Piknikut është ditë mësimi dhe organizohet brenda territorit të komunës së Shtimes, zakonisht në fshatin Llanisht. Meqenëse territori i komunës sonë është i vogël, me miratim paraprak të prindërve të nxënësve janë lejuar të vizitojnë Parkun Nacional “Gërmia” në Prishtinë dhe fshatin piktoresk të Jezercit (Ferizaj).

FESTIMI I DITËVE TË SHKOLLAVE

Për çdo vit, shkollat e komunës së Shtimes, shënojnë ditat e tyre të shkollave. Programi zakonisht përmban pjesë të zgjedhura artistike dhe profesionale, të cilin e përgatisin mësimdhënësit dhe nxënësit. Ditat e shkollave festohen më:

- 20 Maj – Dita e SHFMU “Lasgush Poradeci” në Muzeqinë;
- 25 Maj – Dita e Gjimnazit “Naim Frashëri” në Shtime;
- 29 Maj – Dita e SHFMU “Idriz Ajeti” në Pjetërshticë;
- 30 Maj – Dita e SHFMU “Bajram Curri” në Petrovë;
- 5 Qershor – Dita e SHFMU “Hasan Prishtina” në Godanc;

- 10 Qershor – Dita e SHFMU “Emin Duraku” në Shtime;
11 Qershor – Dita e SHFMU “Skënderbeu” në Reçak;
14 Qershor – Dita e SHFMU “Abdullah Shabani” në Carralevë.

JAVA E DYERVE TË HAPURA NË SHKOLLËN PROFESIONALE DHE GJIMNAZ

Drejtorja e Arsimit, në bashkërendim me drejtorët e shkollave fillore dhe të mesme të ulëta dhe MASHT-in, në funksion të orientimit në karrierë dhe informimit të nxënësve të klasave të nënta (IX), me drejtimet (profilet) e shkollave të mesme të larta, nga data 26 – 29. 4. 2022 kanë organizuar aktivitetin “Java e dyerve të hapura”.

Për një informim sa më të detajuar, shkollat e mesme të larta, nxënësit vizitor i kanë njoftuar përmes informatave, si: Pankarta, prezantime mbi sukseset dhe rezultatet e shkollës, stafin e mësimeve, kushtet brenda shkollës, ku nxënësit zhvillojnë praktikën profesionale, profilet që ofrojnë këto shkolla dhe mundësitë e inkuadrimin në tregun e punës pas përfundimit të shkollës së mesme profesionale. Pra, e gjithë kjo ka reflektuar pozitivisht, sepse nxënësit janë të mirë-informuar për mundësitë që ofrojnë këto shkolla në zhvillimin e tyre profesional dhe mundësitë për punësim pas përfundimit të shkollës së mesme profesionale.

JAVA E INFORMIMIT NË GJIMNAZE PËR ORIENTIM NË KARRIERË

Për orientim në karrierë janë zhvilluar një sërë aktiviteteve nga 26 – 29 prill 2022, të cilat janë përcaktuar për të ndihmuar nxënësit e klasave të XII-ta të zgjedhin drejtimet e tyre në arsimin e lartë. Ky aktivitet ka pasur për qëllim që nxënësit gjatë këtyre ditëve të marrin sa më shumë informata rreth mundësive ekzistuese për orientim në karrierë në Republikën e Kosovës. Kjo ka ndikuar fuqishëm tek nxënësit maturan në marrjen e vendimeve të mirëinformuara dhe vetëdijesimin e tyre të mirëfilltë për mundësitë ekzistuese në zhvillimin e tyre profesional, vazhdimin e studimeve dhe punësimit të tyre pas përfundimit të arsimit të lartë. MASHTI ka siguruar materialet shtesë për organizimin e këtij aktiviteti duke përgatitur pankarta me mundësitë dhe informatat shtesë për orientim në karrierë.

APLIKIMI I TEKNOLOGJISË INFORMATIVE NËPËR MËSONJËTORE

Siç dihet në kohën më bashkëkohore ndikimi i teknologjisë informative dhe komunikimit (TIK) gjithnjë e më shumë po bëhet gjithëpërfshirës në shumë sfera shoqërore. Ky zbatim nuk e anashkallon as sistemin e arsimit në komunën tonë. Andaj, arsimimi dhe dituria janë baza e çdo zhvillimi njerëzor dhe ato janë e drejta fundamentale për çdo qenie njerëzore. Dominimi i metodave tradicionale, të cilat kanë fuqizuar njohurinë enciklopedike dhe jo specifike apo praktike të nxënësve, mungesa e mësimeve interaktive dhe inovacioneve bëjnë që teknologjia informative dhe komunikimit të shfrytëzohet si reformatör për t'i plotësuar kërkesat globale për mësime sa më pragmatike dhe për t'i ndjekur trendet bashkëkohore arsimore ku nxënësi vendoset në qendër të vëmendjes për të rritur të menduarit kritik, me qëllim për të ardhur deri te zgjedhja e problemeve. Nevoja dhe arsyja e aplikimit të TIK-ut në arsim niset nga fakti i përgatitjes së të rinjve për t'u bërë liderë të suksesshëm në këtë shoqëri të udhëhequr nga informacionet. Aftësitë e komunikimit, procesimit, mendimit kritik dhe zgjedhjes së problemeve si dhe puna në grupe janë esenciale në shoqërinë teknologjike dhe socio-ekonomike të shekullit 21. Arsimimi në këtë mjedis të sofistikuar do të bëjë më shumë se vetëm lexim, shkrim apo përvetësim të shkathtësive aritmetike. Duhet të ofrojmë edhe shkathtësi pune që do t'i ndihmonin të rinjtë të arrijnë potencialin e tyre njerëzor. Zhvillimi i teknologjisë informative dhe komunikimit paraqet një nga detyrat prioritare të të gjitha qeverive botërore dhe padyshim se arsimimi është njëri nga segmentet kryesore në nxitjen dhe përkrahjen e zhvillimit të saj. Duke marrë të gjitha këto për bazë edhe në institucionet tona edukativo-arsimore të komunës së Shtimes pajisjet e teknologjisë informative shfrytëzohen pothuajse në çdo mësonjëtorë duke përfshirë këtu: Llaptopë, projektorë, tabela të meçura, kompjuterë (PC), smart TV e të tjerë.

Meqenëse për pajisje të teknologjisë informative kishin nevojë edhe Qendrat Mësimore, përfaqësuesit e Misionit të OSBE-së, Francisco Jose Garcia Martinez dhe Muharrem Haziri, më **2. 3. 2022** kanë sjellë një donacion me mjete të teknologjisë për tri Qendra Mësimore të komunës së Shtimes. Pranimi i këtij donacioni është bërë nga shkollat: “Emin Duraku” në Shtime dhe “Lasgush Poradeci”, paralelja e ndarë në Gjurovc dhe Vojnovc. Në pranimin e këtij donacioni kanë marrë pjesë edhe përfaqësuesit e Qendrave Mësimore, të cilët janë ndarë tejet të kënaqur me këtë donacion të OSBE-së. Donacioni i OSBE-së ka të bëjë me pajisje të teknologjisë informative, siç janë: projektorë, printerë dhe kompjuterë.

Gjatë këtij viti shkollor, organizata “Kosovo United States Alumni”, përmes projektit “School Learning Hubs”, të implementuar nga KUSA, në SHMU “Emin Duraku” në Shtime, ka realizuar aktivitete shkollore me Klubet e Debatit dhe Komunikimit, Teknologjisë dhe Inovacionit si dhe Aktivitete në Natyrë. Për të ofruar një mundësi nxënësve tanë që duan t'i zhvillojnë tutje pasionet e tyre dhe të mësojnë më shumë për temat, të cilat ju interesojnë atyre, KUSA, më **29 qershor 2022** ka dhuruar dy (2) laptopë për SHMU “Emin Duraku”, të cilët sadopak do të lehtësojnë punën e klubeve shkollore.

INVESTIME KAPITALE NË INFRASTRUKTURË SHKOLLORE

Projektet kapitale për ndërtimin e institucioneve edukativo-arsimore, të nisura vite më parë janë duke vazhduar dhe pritët të përmbyllen sivjet. Objekti shkollor bashkëkohor në fshatin Carralevë, i cili ka sipërfaqe të përgjithshme 3200 m², ndërsa vlera e investimit për ndërtimin e objektit në fjalë është 529,028.60 euro, pritët të inaugurohet me rastin e fillimit të vitit të ri shkollor 2022/2023.

Investim tjetër kapital që ka ndodhur është objekti modern shkollor në fshatin Muzeqinë. Ky objekt shkollor ka sipërfaqe të përgjithshme 3100 m², ndërsa vlera e investimit për ndërtimin e objektit në fjalë është 627,077.72 euro. Në dy objektet e sipërpërmendura, investitor është Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, ku ka participuar edhe Komuna e Shtimes. Për këto dy objekte shkollore, Komuna jonë edhe sivjet ka ndarë një shumë të mjeteve për përrurimin e tyre.

Po ashtu, një investim shumë i rëndësishëm që po ndodhë sivjet, është përgatitja për përfundimin e aneks-objektit shkollor në fshatin Gjurovc. që ka një sipërfaqe prej 715 metra katrorë. Aktualisht, Drejtoria Komunale e Arsimit në bashkëpunim me Drejtorinë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi kanë përgatitur projektin për nisjen e procedurave të prokurimit publik me qëllim që të përfundojnë punimet në shtruarjen e dyshemesë me epoksitë, izolim e fasadim të jashtëm dhe instalimin e ngrohjes qendrore në objektin e vjetër shkollor. Pra, në shtator të këtij viti do të kemi të gatshëm këtë aneks-shkollor për fillimin e vitit të ri shkollor 2022/2023.

Gjithashtu, në kuadër të projektit për eficiencë të energjisë, më 10 maj 2022 kanë filluar punimet rreth renovimit të objektit të SHMU “Emin Duraku” në Shtime. Me këtë projekt do të bëhet rregullimi dhe izolimi i pullazit (aty ku ka qenë e nevojshme), fasadimi i jashtëm dhe izolimi termik i mureve, ndërrimi i dritareve, instalimi i sistemit të ngrohjes qendrore si dhe meremetime të tjera që janë përfshirë në kuadër të këtij projekti. Vlera e këtij projekti është 198,646.50 €.

Po ashtu, në kuadër të projektit për eficiencë të energjisë, në të njëjtën kohë pas përfundimit të procesit mësimor ka nisur renovimi edhe i Gjinnazit “Naim Frashëri” në Shtime. Ky projekt domethënës kap shumë prej 151,079.04 €.

Në vazhden e realizimit të shumë projekteve në komunën tonë, në fshatin Pjetërshticë dhe Petrovë është duke vazhduar ndërtimi i sallave të edukatës fizike dhe sivjet pritët nisja e punimeve për ndërtimin e sallës së edukatës fizike në fshatin Reçak si dhe një depo për nevoja të Institucionit Parashkollor “Albiona Asllani” në Shtime.

Me një ceremoni të veçantë, më **18 mars 2022** në Institucion Parashkollor “Albiona Asllani” në Shtime është bërë përrurimi i ateliejes nga përfaqësuesit e organizatës implemtuese Volontari nel Mondo RTM, Valentina Zefi, përfaqësuese ligjore e shoqatës italiane RTM për Kosovë, Matteo Mancini, koordinator i projektit PEDAKOS, drejtori i Arsimit, Lulzim Sahiti dhe drejtoresha e Çerdhes, Kimete Hoxha-Jakupi. Këtë ceremoni festive e bënë edhe më madhështore, pjesëmarrja e fëmijëve të kopshtit, me punimet e tyre të mrekullueshme të punuara brenda Atelesë. Atelie / Hapësira edukative në Institucionin Parashkollor “Albiona Asllani” në Shtime është mundësuar nga Projekti PEDAKOS, të financuar nga Qeveria Italiane nëpërmjet Agjencisë Italiane për Bashkëpunim dhe Zhvillim dhe realizuar nga shoqata italiane Volontari nel Mondo RTM me mbështetjen e Ambasadës Italiane në Prishtinë. E tërë veprimtaria në këtë projekt, bazohet në trajnime, përvoja dhe shkëmbime me kopshtet e Reggio Emilia-s duke marrë përvoja dhe praktika të mira të Qasjes Reggio Emilia, e njohur dhe e kërkuar botërisht dhe duke i adoptuar në aktivitete me fëmijë. Përveç trajnimeve dhe përvojave praktike në vend dhe jashtë vendit, kopshtet përfituese të projektit, përfitojnë edhe intervenime të ndryshme në inventar dhe material didaktik duke rikualifikuar hapësirat ekzistuese. Qëllimi i intervenimeve në hapësira bëhet në mënyrë që të realizohen projekte edukative për fëmijë ku sipas filozofisë së Reggio Emilia-s “Ambienti” është një edukator i tretë.

Më **15 prill 2022** është asfaltuar rruga në hyrje të IP “Albiona Asllani”

Më **31 maj 2022** në oborrin e Institucionit Parashkollor “Albiona Asllani” në Shtime janë mbëltuar 87 fidane nga Komuna e Shtimes.

Më **5 qershor 2022** organizata gjermane “KuKuk Kultur”, e udhëhequr nga koordinatorja e projektit, Ganimete Pronaj, mësimdhënësi Jörg Juli dhe 20 nxënësit vullnetarë të Montessorischule nga Potsdami i Gjermanisë, të mbështetur nga DKA dhe Qendra Mësimore në Shtime, kanë ndërtuar Këndin e Lojërave për Fëmijë në oborrin e shkollës fillore “Emin Duraku” në Shtime që kushton rreth 20 mijë euro. Vlen të përmendet se këtë projekt e kanë mbështetur edhe afaristët shtimjanë.

Pas kërkesës nga DKA në adresë të MASHTI-it për nevoja të mirëmbajtjes së objekteve shkollore, më **27 qershor 2022** kemi siguruar tri pako për mirëmbajtje të brendshme dhe të jashtme të institucioneve shkollore: Gjimnazi “Naim Frashëri”, SHMU “Emin Duraku” dhe Shkolla e Mesme Profesionale në Shtime. Vlera e këtij projekti është rreth 120 mijë euro. Secila pako përmbanë në vete 43 pajisje moderne.

PËRFUNDIMI I VITIT MËSIMOR DHE SUKSESI I NXËNËSVE NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR

Viti mësimor ka përfunduar më **24 qershor 2022** në të gjitha shkollat e komunës së Shtimes. Institucionet shkollore kanë kompletuar suksesin e nxënësve për vitin mësimor 2021/2022.

Në shkollat fillore dhe të mesme të ulëta, bëjnë pjesë gjithsej **7** shkolla amë me **9** paralele të ndara fizike, ku mësimin, në vitin shkollor **2021/22**, e kanë vijuar **3590** nxënës, të shpërndarë në **191** paralele, që i bie mesatarisht **18,79** nxënës për paralele, prej tyre: Në nivelin e arsimit fillor, **I-V**, janë **2023** nxënës, të shpërndarë në **110** paralele, mesatarisht **18,39** nxënës për paralele, ndërsa në nivelin e arsimit të mesëm të ulët, **VI-IX**, janë gjithsej **1567** nxënës, të shpërndarë në **81** paralele, mesatarisht **19,34** nxënës për paralele. Në këtë numër, të përgjithshëm të nxënësve, nuk janë përfshirë **373** fëmijë të nivelit parafillor (**22** paralele), ku mesatarisht **16,95** është numri i fëmijëve për paralele.

Ndërkaq, në nivelin e arsimit të mesëm të lartë, **X-XII**, janë gjithsej **1136** nxënës, të shpërndarë në **55** paralele, mesatarisht **20,65** nxënës për paralele.

Suksesi i nxënësve në nivelin e parë të arsimit (I-V)

Në nivelin fillor të arsimit, kalueshmëria e nxënësve është: **1997** nxënës me sukses pozitiv ose **98.72** për qind, **14** me sukses të pamjaftueshëm ose **0.69** për qind dhe **12** nxënës të panotuar ose **0.59** për qind, gjegjësisht:

- Me sukses të shkëlqyeshëm janë: 1127 nxënës ose 55.71 për qind
- Me sukses shumë të mirë janë: 411 nxënës ose 20.32 për qind
- Me sukses të mirë janë: 323 nxënës ose 15.97 për qind
- Me sukses të mjaftueshëm janë: 136 nxënës ose 6.72 për qind
- Me sukses të pamjaftueshëm janë: 14 nxënës ose 0.69 për qind
- Të panotuar janë: 12 nxënës ose 0.59 për qind

Suksesi i nxënësve në vitin shkollor 2021/22 – Niveli i arsimit fillor (I-V)

Emri i shkollës		Nr. i paraleleve	Nr. i nxënësve			Kaluan klasën me sukses								Përcillen		Të pa notuar		Gjithsej orë gjatë vitit		Nota mesatare
						Shëlqyeshëm		Shumë mirë		Mirë		Mjaftueshëm		Me nota negative				Të planifikuara	Të mbajtura	
			M	F	GJ	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%			
1	"A. Shabani"	10	69	70	139	75	53.96	18	12.95	21	15.11	15	10.79	4	2.88	6	4.32	8370	8314	3.91
2	"B. Curri"	15	122	119	241	131	54.36	52	21.58	46	19.09	12	4.98	0	0.00	0	0.00	12609	12462	4.25
3	"E. Duraku"	40	457	440	897	498	55.52	191	21.29	139	15.50	54	6.02	10	1.11	5	0.56	31013	30518	4.22
4	"H. Prishtina"	10	98	74	172	89	51.74	44	25.58	28	16.28	10	5.81	0	0.00	1	0.58	8216	7954	4.22
5	"I. Ajeti"	5	62	59	121	65	53.72	30	24.79	12	9.92	14	11.57	0	0.00	0	0.00	4016	3981	4.21
6	"L. Poradeci"	25	173	146	319	199	62.38	51	15.99	50	15.67	19	5.96	0	0.00	0	0.00	19980	19895	4.35
7	"Skënderbeu"	5	72	62	134	70	52.24	25	18.66	27	20.15	12	8.96	0	0.00	0	0.00	1078	1053	4.14
Gjithsej:		110	1053	970	2023	1127	55.71	411	20.32	323	15.97	136	6.72	14	0.69	12	0.59	85282	84177	4.22

Suksesi i nxënësve në nivelin e dytë të arsimit (VI-IX)

Në nivelin mesëm të ulët të arsimit, kalueshmëria e nxënësve është: **1567** nxënës me sukses pozitiv ose **91.91** për qind, **106** me sukses të pamjaftueshëm ose **6.76** për qind dhe **20** nxënës të panotuar ose **1.28** për qind, gjegjësisht:

- Me sukses të shkëlqyeshëm janë: 440 nxënës ose 28.08 për qind
- Me sukses shumë të mirë janë: 331 nxënës ose 21.12 për qind
- Me sukses të mirë janë: 410 nxënës ose 26.12 për qind
- Me sukses të mjaftueshëm janë: 260 nxënës ose 16.59 për qind
- Me sukses të pamjaftueshëm janë: 106 nxënës ose 6.76 për qind
- Të panotuar janë: 20 nxënës ose 1.28 për qind

Suksesi i nxënësve në vitin shkollor 2021/22 – Niveli i arsimit të mesëm të ulët (VI-IX)

Emri i shkollës		Nr. i paraleleve	Nr. i nxënësve			Kaluan klasën me sukses								Kanë përsëritur klasën		Të pa notuar		Gjithsej orë gjatë vitit		Nota mesatare
						Shëlqyeshëm		Shumë mirë		Mirë		Mjaftueshëm		Me nota negative				Të planifikuara	Të mbajtura	
			M	F	GJ	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%			
1	“A. Shabani”	8	56	74	130	45	34.62	22	16.92	32	24.62	22	16.92	5	3.85	4	3.08	8557	8126	3.52
2	“B. Curri”	12	80	85	165	43	26.06	39	23.64	39	23.64	25	15.15	18	10.91	1	0.61	12368	11438	3.37
3	“E. Duraku”	28	329	320	649	154	23.73	120	18.49	166	25.58	114	17.57	81	12.48	14	2.16	30233	26346	3.17
4	“H. Prishtina”	8	85	75	160	26	16.25	29	18.13	62	38.75	42	26.25	0	0.00	1	0.63	2087	2033	3.23
5	“I. Ajeti”	4	46	40	86	27	31.40	28	32.56	19	22.09	12	13.95	0	0.00	0	0.00	4222	4065	3.81
6	“L. Poradeci”	17	154	121	275	115	41.82	66	24.00	59	21.45	33	12.00	2	0.73	0	0.00	18722	18657	3.94
7	“Skënderbeu”	4	60	42	102	30	29.41	27	26.47	33	32.35	12	11.76	0	0.00	0	0.00	1063	990	3.74
Gjithsej:		81	810	757	1567	440	28.08	331	21.12	410	26.16	260	16.59	106	6.76	20	1.28	77252	71655	3.43

Vërejtje: Në Shkollën e Mesme të Ulët "Emin Duraku" 20 nxënës kanë përsëritur vitin, ndërsa 61 nxënës janë në riprovim.

Suksesi i nxënësve në nivelin e tretë të arsimit (X-XII), përkatësisht në Gjimnazin “Naim Frashëri” dhe Shkollën e Mesme Profesionale

Në nivelin mesëm të lartë të arsimit, kalueshmëria e nxënësve është: **1136** nxënës me sukses pozitiv ose **89.87** për qind, **60** me sukses të pamjaftueshëm ose **5.28** për qind dhe **55** nxënës të panotuar ose **4.84** për qind, gjegjësisht:

- Me sukses të shkëlqyeshëm janë: 177 nxënës ose 15.58 për qind
- Me sukses shumë të mirë janë: 203 nxënës ose 17.87 për qind
- Me sukses të mirë janë: 368 nxënës ose 32.39 për qind
- Me sukses të mjaftueshëm janë: 273 nxënës ose 24.03 për qind
- Me sukses të pamjaftueshëm janë: 60 nxënës ose 5.28 për qind
- Të panotuar janë: 55 nxënës ose 4.84 për qind

Suksesi i nxënësve në vitin shkollor 2021/22 – Niveli i arsimit të mesëm të lartë (X-XII)

Emri i shkollës		Nr. i paraleleve	Nr. i nxënësve			Kaluan klasën me sukses								Kanë përsëritur klasën		Të pa notuar		Gjithsej orë gjatë vitit		Nota mesatare
						Shëlqyeshëm		Shumë mirë		Mirë		Mjaftueshëm		Me nota negative				Të planifikuara	Të mbajtura	
			M	F	GJ	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%			
			1	“N. Frashëri”	26	305	349	654	73	11.16	132	20.18	224	34.25	151	23.09	52	7.95	22	
2	Shk.Me. Profesionale	29	276	206	482	104	21.58	71	14.73	144	29.88	122	25.31	8	1.66	33	6.85	17097	16418	3.09
Gjithsej:		55	581	555	1136	177	15.58	203	17.87	368	32.39	273	24.03	60	5.28	55	4.84	43485	39769	3.00

Vërejtje: Në Gjimnazin “Naim Frashëri” 8 nxënës kanë përsëritur vitin, ndërsa 44 nxënës janë në riprovim. Në Shkollën e Mesme Profesionale gjithashtu 8 nxënës kanë përsëritur vitin.

GJASHTËMUJORI I DYTË (II)

Në gjashtëmuorin e dytë të punës, në të gjitha Institucionet Edukativo-Arsimore të Komunës së Shtimes, synimi i përgjithshëm i DKA-së, ka qenë dhe mbetet, ngritja e cilësisë në procesin edukativo-arsimor, përmirësimi i infrastrukturës së IEA ve, ngritja profesionale e personelit arsimor, zhvillimi dhe zbatimi i aktiviteteve pedagogjike, administrative, juridike dhe financiare.

Drejtoria Komunale e Arsimit, në bashkëpunim me drejtorët e institucioneve-edukativo-arsimore ka bërë përgatitjet e duhura për fillimin e vitit shkollor 2022/2023. Pra, gjatë gjashtëmuorit të dytë të këtij viti, kemi punuar me intensitet të shtuar për realizimin punëve dhe detyrave që kemi pasur. Me këtë rast, po i listojmë disa nga aktivitetet kryesore të realizuara gjatë kësaj periudhe kohore:

- ✓ Gjatë vitit fiskal 2022, Drejtoria Komunale e Arsimit ka shpallur gjithsej 37 konkurse publike (8 janë anuluar) për pranimin e personelit arsimor, administrativ dhe teknik për institucionet edukativo-arsimore të komunës sonë. Të gjitha konkursat janë publikuar në portalin shtetëror dhe në web-faqen zyrtare të Komunës së Shtimes. Me këtë rast, kanë konkurruar 287 aplikantë prej të cilëve janë pranuar 50 veta (13 meshkuj dhe 37 femra). Aktualisht në proces kemi edhe tri (3) konkurse publike për 3 vende të lira të punës.
- ✓ Gjatë këtij viti janë pensionuar 17 punonjës në sektorin e arsimit, kurse 19 mësimdhënësë kemi pasur në pushim të lehonisë dhe 10 të tjerë në pushim pa pagesë.

- ✓ Kemi mbajtur takime të rregullta me drejtorë të shkollave;
- ✓ Më 9. 11. 2022, DKA ka mbajtur takim pune me pedagogë dhe psikologë të institucioneve arsimore ku është koordinuar puna e tyre në terren;
- ✓ Është bërë analiza e suksesit pas përfundimit të vitit mësimor 2021/2022;
- ✓ Në aftin e dytë të gushtit, më 27 gusht 2022, Provimit Shtetëror të Maturës i janë nënshtruar gjithsej 79 maturantë, prej të cilëve 34 nxënës janë të Gjimnazit “Naim Frashëri” dhe 45 nxënës të Shkollës së Mesme Profesionale në Shtime.

Provimi i Maturës Shtetërore është një instrument matës, ku maturantët mund të tregojnë aftësitë dhe shkathtësitë e tyre, të cilat i kanë përvetësuar gjatë tri viteve të shkollimit të mesëm të lartë (X-XII). Divizioni për Standarde, Vlerësim dhe Monitorim, më 6 shtator 2022 ka bërë publike rezultatet. Shih më poshtë tabelën:

Rezultatet e Provimit të Maturës Shtetërore (afati i gushtit) në formë tabelare

Shkolla	Drejtimi	Nxënës që kanë hyrë në provim	Nxënës që kanë kaluar testin	Përqindja e kalueshmërisë	Përqindja e kalueshmërisë për shkollë
Gjimnazi “Naim Frashëri”	Gjimnazi Natyror	15	13	86.66 %	67.64 %
	Gjimnazi Shoqëror	19	10	52.63 %	
Shkolla e Mesme Profesionale	Ekonomi	17	9	52.94 %	48.88 %
	Makineri	7	5	71.42 %	
	Elektroteknikë	6	4	66.66 %	
	Bujqësi	3	1	33.33 %	
	Administratë	7	2	28.57 %	
	Hoteleri	3	0	00.00 %	
	Shëndetësi	2	1	50.00 %	
Totali:		79	45	56.96 %	

- ✓ Është bërë hormanizimi dhe plotësimi i orëve mësimore të mësimdhënësve;
- ✓ Përgatitja dhe hapja e konkursit për regjistrimin e nxënësve në klasën e dhjetë (10) në arsimin e mesëm të lartë (Afti i Gushtit), ku më 22, 23 dhe 24 gusht 2022, ku janë plotësuar vendet e lira në Gjimnazin “Naim Frashëri” dhe në Shkollën e Mesme Profesionale në Shtime;
- ✓ Është bërë pastrimi gjeneral i të gjitha hapësirave të jashtme dhe të brendshme shkollore;
- ✓ Pas përfundimit të vitit mësimor kanë nisur punimet në renovimin e objekteve shkollore, përkatësisht në SHMU “Emin Duraku” dhe në Gjimnazin “Naim Frashëri” në Shtime. Ky projekt ka të bëjë me zbatimin e masave të efijencës së energjisë.
- ✓ Është kontraktuar operatori ekonomik për furnizim të institucioneve shkollore me material pedagogjik (ditar shkollor, libra amë etj.) për këtë vit shkollor;
- ✓ Për furnizim me libra shkollor janë bërë përgatitjet e duhura. Me këtë rast, brenda afatit të caktuar kohor janë përzgjedhur tekstet nga Aktivitet Profesionale nëpër shkolla sipas katalogjeve të MASHTI-t. Gjithashtu është bërë kërkesa në adresë të MASHTI-t për furnizim me 431 abetare të reja, të cilat do të përdoren nga 1 shtatori në Kosovë dhe Shqipëri. Më 20 gusht 2022 kemi pranuar tekstet shkollore nga shtëpitë botuese “Dukagjini”, “Magjia e librit”, “Alabasi”, “Berati”, “Luarasi”, “Pegi” dhe “Libri shkollor”. Komisioni komunal për pranimin, evidentimin dhe shpërndarjen e teksteve shkollore ka nisur shpërndarjen e tyre nëpër institucione arsimore më 22. 8. 2022;
- ✓ **Përgatitja dimërore:** Meqenëse është paralamëruar se dimri i këtij viti do të jetë mjaft sfidues për shkak të krizës energjetike botërore, përgatitjet për stinën e dimrit në të gjitha institucionet edukativo-arsimore të komunës sonë kanë filluar me kohë. Siç dihet mirëfilli, shkollat tona burim kryesor për ngrohje kanë lëndën djegëse - drurin dhe peletin, për të cilat njësitë buxhetore, gjegjësisht shkollat kanë bërë me kohë zotimin e mjeteve financiare, mirëpo gjatë fazës së zhvillimit të procedurave të prokurimit ka pasur inflacion të madh, gjë që ka ndikuar drejtpërdrejt në ngritjen e çmimeve të larta të lëndëve djegëse. Për këtë çështje janë

shkaktuar vonesa për sigurimin e druve dhe peletit. Megjithatë, është bërë me kohë furnizimi me dru i institucioneve arsimore, gjë që të gjitha shkollat janë furnizuar me lëndë djegëse. Ndërkaq, sa i përket peletit për shkak të çmimeve të larta procedurat e prokurimit kanë zgjatur pak më shumë mirëpo operatori ekonomik i kontraktuar për këtë lëndë djegëse ka bërë furnizimin e menjëherëshëm me pelet për të gjitha institucionet.

- ✓ Nga 1-12 korrik 2022 ka qenë afati për regjistrimin e fëmijëve në Institucionin Parashkollor “Albiona Asllani” në Shtime, ku gjatë kësaj kohe kanë konkurruar gjithsej 47 fëmijë të moshave të ndryshme. Me këtë rast, komisioni për verifikimin e dokumentacionit të aplikantëve, më 14 korrik 2022 ka bërë pranimin e 38 fëmijëve për vitin shkollor 2022/2023 duke u bazuar në Udhëzim Administrativ (MASHT) nr. 03/2022 për përfshirjen e fëmijëve në institucione parashkollore në Kosovë dhe Vendimit të DKA-së, nr. 05/519, të datës 30. 6. 2022, për kriteret e pranimit të fëmijëve në Institucionin Parashkollor “Albiona Asllani” në Shtime;
- ✓ Në garën e madhe të Robotikës, të organizuar më 6 korrik 2022 nga Kosova Makers League Open, nxënësit e SHFMU “Lasgush Poradeci” të Muzeqinës: Buna Shahini, Dhurata Biba, Leonis Kolgeci dhe Ideal Kurtishi kanë triumfuar në katër raundet duke zënë vendin e parë në nivel të Republikës së Kosovës. Në sfidën e katërt të kësaj gare, morën pjesë 70 ekipe nga 20 komuna të ndryshme të Kosovës, në të cilën nxënësit tanë kanë treguar aftësitë e tyre në gjuhët programuese;
- ✓ Kemi subvencionuar transportin e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore, të cilët ndjekin mësimet në Qendrën Burimore në Prizren, Prishtinë dhe Shkollën Speciale “Shpresa” në Shtime;
- ✓ Në Qendrën Mësimore në Gjurkovc prej datës 8 – 30 gusht 2022 është zhvilluar program veror;
- ✓ Më 3 gusht 2022 kemi shpallur rezultatet për ndarjen e 50 bursave për studentë për vitin akademik 2022/2023. Prej tyre, 27 studentë janë përfitues të bursës nga Universiteti i Prishtinës, ndërsa 23 nga kolegjet private. Përfitues të bursës komunale janë 36 femra dhe 14 meshkuj. Bursat janë ndarë për 10 (dhjetë) muaj dhe shuma mujore e tyre është 50 euro për student, gjegjësisht 500 euro për një vit. Ceremonia e nënshkrimit të kontratës me studentët përfitues të bursës komunale është mbajtur në sallën e Kuvendit të Komunës më 1 shtator 2022. Kësti i parë është alokuar në xhirollogari të studentëve në muajin shtator, kurse kësti i dytë në muajin tetor. Pra, të gjitha obligimet e DKA-së ndaj studentëve kanë përfunuar me kohë, konform kontratës së nënshkruar me ta.
- ✓ Më 30 gusht 2022 është përruruar murali në hapësirën e jashtme të SHF “Emin Duraku”. Ky projekt është realizuar në kuadër të aktivitetit: “Me ngjyra për drejtësi”, i cili është financuar nga Departamenti i Shtetit Amerikan, ndërkaq është implementuar nga organizata Qendra për Zhvillimin e Artit “Q’ART” në bashkëpunim me organizatën “Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut” (YIHR-KS). Murali në fjalë, ka aspektin edukativ, arsimor, rinor dhe estetik;
- ✓ Më 6 shtator 2022 është nënshkruar Memorandumi i Mirëkuptimit në mes të Komunës së Shtimes dhe “Teach for Kosova” për implementimin e projektit “Promovimi i të menduarit kritik dhe kohezionit multietnik tek të rinjtë”;
- ✓ Me inicim të DKA-së kanë nisur procedurat e ndërrimit të emrit të Shkollës së Mesme të Lartë Profesionale në Institucioni i Arsimit dhe Aftësimi Profesional (IAAP) në Shtime. Kështu që në mbledhjen e Kuvendit të Komunës së Shtimes, të mbajtur më 31 tetor 2022 unanimisht është miratuar vendimi për ndërrimin e emrit të sipërpërmendur në IAAP. Ndërrimi i këtij emri jep mundësi për zgjedhjen e drejtimeve dhe profileve të reja arsimore konform nevojave të tregut të punës;
- ✓ Në Rektoratin e Universitetit të Prishtinës, më 7 shtator 2022 është nënshkruar Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet UP-së dhe Komunës së Shtimes. Përmes kësaj marrëveshje, studentëve shtimjanë u ofrohet mundësia për realizimin e praktikës profesionale, hormanizimin e përmbajtjeve mësimore me nevojat e tregut të punës etj;

- ✓ Pas kërkesës së DKA-së në MASHTI për pajisje laboratorike, më 2 gusht 2022 kemi siguruar një kabinet për lëndët shkencore, në vlerë prej 49,818.05 euro. Ky kabinet është vendosur në SHMU "Emin Duraku";
- ✓ Me rastin e 5 Tetorit – Ditës Ndërkombëtare të Mësuesit, Gjimnazi "Naim Frashëri" në Shtime është pajisur me teleskop solar nga drejtori i organizatës "Astronomy Outreach of Kosovo", prof. Milaim Rushiti. Ky teleskop solar shërben për vrojtimin e diellit me mbledhje drite të gjatësisë valore të dukshme dhe ai mund të përdoret gjatë ditës, gjë që është e para shkollë që pajiset me këtë teleskop diellor;
- ✓ Falë një donacioni nga MASHTI prej 120 mijë euro, më 11 tetor 2022 kemi furnizuar tri institucione arsimore (SHFMU "Idriz Ajeti" në Pjetërshticë, SHFMU "Lasgush Poradeci" në Muzeqinë dhe SHFMU "Abdullah Shabani" në Carralevë) me pajisje moderne për mbrojtjen e objekteve arsimore për qëndrueshmëri dhe pako të nevojshme për fusha lëndore dhe mirëmbajtje të institucioneve arsimore;
- ✓ Nga organizata "Humanity First" me seli në Gjermani, SHMU "Emin Duraku" në Shtime ka marr një donacin prej 50 kompjuterë dhe katër kamera vëzhguese për SHFMU "Emin Duraku", paralelja e ndarë në Davidovc. Përrurimi i këtij Kabineti të Teknologjisë Informative u bë më 13 tetor 2022;
- ✓ Më 21 tetor 2022 kanë filluar punimet për ndërtimin e depos për vendosjen e peletit dhe paisjeve tjera të IP "Albiona Asllanit". Punimet kanë përfunduar me sukses në muajin dhjetor dhe tashmë është në shfrytëzim të institucionit në fjalë.
- ✓ Për t'ju mundësuar arsimim të përshtatshëm secilit nxënës, në vitin shkollor 2022/2023, Ekipi Vlerësues Pedagogjik për Fëmijë/Nxënës me Nevoja të Veçanta Arsimore ka evidentuar gjithsej 28 nxënës me nevoja të veçanta arsimore. Procesi i vlerësimit pedagogjik ka nisur më 10. 11. 2022 dhe ende po vazhdon. Bazuar në nevojat individuale të tyre, deri më tash janë vlerësuar 25 nxënës.
- ✓ Me kërkesë të DKA-së në Drejtorinë e Urbanizmit, kanë nisur procedurat e shpronësimit të pronës private për nevoja të rrugës së SHFMU "Abdullah Shabani" në Carralevë. Me këtë rast, në mbledhjen e Kuvendit të Komunës së Shtimes, të mbajtur më 31. 10. 2022 unanimisht është shpronësuar prona prej 1.80 ari që ishte problem në vete prej shumë vitesh;
- ✓ Në SHF "Emin Duraku" në Shtime, më 21 nëntor 2022 është mbajtur Olimpiada Komunale Matematike, ku 27 nxënës të shkollave të komunës së Shtimes, kanë sfiduar dijen e tyre për t'u kualifikuar për Olimpiadën Matematike të Kosovës. Me këtë rast, shtatë nxënës të klasave IX, X, XI dhe XII janë kualifikuar për garën në nivel republikan;
- ✓ DKA në bashkëpunim me QKMF "Dr. Vezir Bajrami" në Shtime, më 21 nëntor 2022 ka nisur kontrollimin sistematik të nxënësve duke filluar në SHFMU "Hasan Prishtina" në Gadanc. Përmes këtij projekti do të kontrollohen të gjithë nxënësit e klasave të para, pesta dhe nënta. Po ashtu për herë të parë janë kontrolluar edhe të gjithë grup-moshat e fëmijëve në IP "Albiona Asllani" në Shtime. Kontrollimi i tyre u bë duke filluar nga pesha dhe gjatësia trupore, higjiena personale, lëkura, ushqyeshmëria, shtylla kurrizore, koshi i krahërorit, deformimi i shputave, shiqimi, dëgjimi, goja, fyti, dhëmbët, çafa, gjëndrrat limfatike, zemra (ritmi, frekuenca, tonet dhe zhurmat), mushkëritë, zëri i frymëmarrjes etj. Gjithashtu për të mbrojtur nga sëmundjet dhe për të parandaluar ndonjë epidemi, në të gjitha shkollat e Shtimes është bërë edhe imunizimi i nxënësve të klasave të para, gjashta dhe të dymbëdhjeta;
- ✓ Në vazhden e realizimit të projekteve infrastrukture në shkollë, më 23 nëntor 2022, ka nisur faza e parë për ndërtimin e sallës së edukatës fizike për SHFMU "Skënderbeu" në Reçak dhe salla e edukatës fizike në SHFMU "Abdullah Shabani", paralelja e ndarë në Zborc;
- ✓ Në Gjimnazin e Specializuar Matematikor në Prishtinë, më 3 dhjetor 2022 është mbajtur Olimpiada Matematike e Kosovës, ku nxënësi i klasës së IX, Front Haxhiu nga SHFMU "Lasgush Poradeci" nga Muzeqina, zuri vendin e katër në nivel republikan. Përndryshe, nxënësi në fjalë është kualifikuar të marr pjesë në Olimpiadën Kombëtare të Matematikës, e cila do të mbahet në muajin korrik 2023;

- ✓ Më 5 dhjetor 2022 nxënësit (VI-IX) e SHMU "Emin Duraku" janë rikthyer në objektin e vet të renovuar nga Fondi i Kosovës për Eficiência të Energjisë;
- ✓ Më 12 dhjetor 2022, në fshatin Rashincë u vë gurthemeli për ndërtimin Observatorit dhe Planetariumit të parë në Kosovë. Vlera e këtij projekti është 310 mijë euro, ku investitor është MASHTI dhe Komuna e Shtimes.
- ✓ Më 14 dhjetor 2022, në bashkëpunim me drejtorinë e shkollës, mësimdhënësit dhe nxënësit e Institucionit të Arsimit dhe Aftësimi Profesional në Shtime është organizuar "Sofra Shkollore". Ky aktivitet me qëllim human është mbajtur për të ndihmuar familjet në nevojë dhe Shtëpinë e të Moshuarve në prag të festive të fundvitit;
- ✓ Me qëllim që të kemi siguri në të gjitha institucionet arsimore, në dhjetor 2022 është bërë servisimi dhe mbushja e aparateve kundër zjarrit nga operatori ekonomik NPSH "Euro-Servis" në Ferizaj me fletëgrancion gjashtëmujor. Po ashtu, më 23 dhjetor 2022 nga eksperti për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, z. Labinot Qarri ka nisur trajnimi për gjithë stafit teknik të institucioneve shkollore si dhe punonjësve të IP "Albiona Asllani". Me këtë rast, do të certifikohen të gjithë pjesëmarrësit e trajnimit nga Qendra e Trajnimit për Sigurnë dhe Shëndetin në Punë;
- ✓ Në këtë periudhë së bashku me drejtorët e institucioneve shkollore kemi bërë planifikimin dhe harmonizimin e buxhetit për vitin fiskal 2023;
- ✓ Në oborrin e Institucionit të Arsimit dhe Aftësimi Profesional në Shtime, më 20 dhjetor 2022 ka nisur pastrimi nga dheu i kanalit kullues;
- ✓ Më 22 dhjetor 2022 është nënshkruar Memorandumi për Bashkëpunim ndërmjet Youth Initiative for Human Rights – Kosovë (YIHR-KS) dhe Drejtorisë Komunale të Arsimit për ngritjen e kapaciteteve dhe trajnimit të mësimdhënësve dhe nxënësve në fushat me interes të përbashkët;
- ✓ Më 23 dhjetor 2022 ka përfunduar renovimi i objekteve shkollore, gjegjësisht aneksi shkollor në fshatin Gjurmoc, ku është shtruar dyshemeja me epoxit, izolimi dhe fasadimi i jashtëm, rregullimi i ngrohjes qendrore në objektin e vjetër shkollor, ngjyrosja e mësonjëtreve dhe korridorit, shtegu për nxënës është rregulluar me kubëza betoni etj. Në objektin e ri shkollor në Muzeqinë janë rregulluar shkallët emërgjente, mbuloja në hyrje të shkollës, ndryçimi në holin e shkollës, pastaj është shtruar rruga me kubëza betoni në hyrje të shkollës si dhe drejt fushës sportive, janë rregulluar përjashta pllakat e dëmtuara të qeramikës, janë rregulluar muret në korridor të dëmtura nga lagështia si dhe është vendosur kaldaja e re për ngrohje qendrore. Ndërkaq, në shkollën e re të Carralevës, në hyrje të saj është rregulluar hapësira e jashtme me kubëza betoni, përreth shkollës është shtruar një pjesë me beton, është rregulluar pompa për furnizim me ujë të pijshëm dhe një hidrantë brenda shkollës, gjithashtu është bërë pastrimi gjeneral i hapësirave të brendshme shkollore. Punimet janë kryer nga operatori ekonomik "U-Unique" në vlerë 89.585.78 euro, mjete këto të buxhetit të Komunës së Shtimes.

PËRFUNDIM

Si përfundim i gjithë kësaj, Drejtoria Komunale e Arsimit, gjatë këtij viti shkollor në qendër ka pasur bashkëpunimin me drejtorë të institucioneve arsimore dhe aktivet profesionale të shkollave, për t'i fuqizuar rezultatet e të nxënësve si dhe harmonizuar aktivitetet mësimore në arritjen e kompetencave, dijeve e shkathtësive të nxënësve. Pra, me një ekip të mirë punës, synimet pa dyshim do të bëhen realitet.

